



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE



Datë: 04.03.2022

Në bazë të nenit 13, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenit 12, të Rregullores së Ministrisë së Financave dhe Transfereve, MF-Nr.04/2017, të datës 13.06.2017, mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të Organizatave Jo Qeveritare, Rregullores komunale për ndarjen e subvencioneve, nenin 44, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, bën këtë:

THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM

Njoftohen përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile se mundë ti dërgojnë propozimet e tyre për plotësimin e Komisionit vlerësues i cili do të formohet me qëllim të vlerësimit të aplikacioneve për financimin projekteve /programeve, të OJQ-ve që veprojnë në Komunën e Fushë Kosovës për projektet që kontribuojnë në avancimin e shërbimit e shëndetësore dhe shërbimeve sociale të cilat kanë aplikuar sipas thirrjes publike të datës 02.03.2022.

Ky komision do të formohet me qëllim të vlerësimit të aplikacioneve për financimin projekteve/programeve, të OJQ-ve që veprojnë në Komunën e Fushë Kosovës për projektet që kontribuojnë në avancimin e shërbimit e shëndetësore dhe shërbimeve sociale në komunën e Fushë Kosovës ,ku do të plotësohet me:

- Një përfaqësues nga Organizata Jo Qeveritare
- Një përfaqësues nga shoqëria civile në cilësinë e ekspertit

Propozimet tuaja do të jenë të mirëpritura dhe duhet t,i drejtohen Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe të njëjtat duhet të dorëzohen në ndërtesën e Komunës së Fushë Kosovës (zyra pritëse) për shërbim të qytetarëve më së largu deri më datë 16.03.2022

Nr.02/2022

Fushë Kosovë

